



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
KRYETAR
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot

Shkodër, më ____ . ____ . 2023

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN E REALIZIMIT TË PROCEDURËS NË NJË KONTRATË

OBJEKTI I PROCEDURËS: Shërbimi i pastrimit zona "Lindore"

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT

Kodi CPV: 90522400-6 - Pastrimi dhe trajtimi i tokës

VLERA E FONDIT LIMIT: 89,023,857(Tetëdhjetë e nentemilion e njëzet e tremijë e teteqind e pesëdhjetë e shtatë) leke pa tvsh.

Në bazë të nenit 39, pika 1, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Shkodër**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin e mosndarjes së procedurës në lote, me përmbajtjen si më poshtë:

Arsyeja kryesore e mosndarjes së procedurës së prokurimit në lote është se referuar preventivit të shërbimit, specifikimeve teknike dhe raportit teknik Autoriteti Kontraktor e ka të pamundur teknikisht ta ndajë këto kontrate në lote të vecanta pasi do duhej që ky territor i Bashkisë Shkodër të ndahej në dy zona gjeografike. Nga eksperiencia e viteve të kaluara ka që kjo kjo praktike ka rezultuar jo efektive dhe shumë e vështirë për tu menaxhuar.

Kjo procedure shërbimi duhet të kryhet nga një operator ekonomik, pasi lloji i shërbimit për të qenë sa më efikas duhet të jetë i përqendruar tek një operator ekonomik . Kryerja nga një operator ekonomik e bën më efektiv organizmin e punës por sidomos e bën shumë më të pershtatshëm monitorimin dhe raportimin e të gjitha proceseve të punës që ky shërbim ka. Ndarja në lote do të sillte konfuzion pasi si pastrimi i rrugëve ashtu edhe evadimi i mbetjeve urbane janë procese të lidhura ngushtë me njëra tjetrën, dhe ndarja e tyre në dy lote do të sillte çrregullim në proces dhe vështirësi në monitorim të shërbimit si dhe kosto shtesë për AK

Per keto arsyeje AK ka vendosur që këto procedure ta zhvillojë pa e ndarë në lote.

Nga ana tjetar referuar Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 2 prashikohet shprehimisht se: “Qëllimi i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Në kreun V, Neni 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, parashikohet shprehimisht:

1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.
2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.

Referuar Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 14, Operatorët ekonomikë, prashikohet shprehimisht se:

1. Kandidatët ose ofertuesit mund të jenë persona fizikë ose juridikë.
2. Grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet t’i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje.

Autoritetet ose entet kontraktore mund t’u kërkojnë grupeve të operatorëve ekonomikë që të marrin një formë ligjore specifike, pasi të jenë shpallur fitues, nëse vlerësohet e nevojshme për realizimin e kontratës. Në çdo rast, ky kusht duhet t’u bëhet i ditur operatorëve ekonomikë në dokumentet e tenderit për ekzekutimin e kënaqshëm të kontratës.

3. Rregullat për mënyrën e plotësimit të kriterëve nga grupet e operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.

Në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Kreu XI, neni 88, është parashikuar:

1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.
2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet

nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.

3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Theksojmë se ndarja ose jo, e kontratës në lote, është një vendim i rëndësishëm që autoriteti kontraktor merr gjatë procesit paraprak të pasi ndikon drejtperdrejt në nivelin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomike në këtë procedurë prokurimi.

Kjo bëhet duke mbajtur në konsideratë elemente të tilla si: tregu, konkurenca e mundshme, vlera e prokurimit, etj., dhe veçanërisht faktin nëse objekti i kontratës është një punë/shërbim/mall për të cilin ofertuesit janë të pakët, kërkon staf teknik, punetore, eksperience dhe organizim të strukturuar.

Në rastin konkret, ndarja në lote e procedurës së prokurimit, do të komplikonte menaxhimin e kontratave dhe shpërndarjen e përgjegjësisë duke e komplikuar realizimin me sukses të kontratës, ndërkohë që në thelb shërbimi është i së njëjtës natyrë. Në këto kushte, gjucojmë se realizimi i procedurës në një kontratë të pa ndarë në lote është një veprim i drejtë dhe në përputhje me frymën e legjislacionit të sipërpërmendur.

Akoma më tej, legjislacioni me ndryshimet e fundit që ka pësuar ka hequr nevojën për kontratë noteriale por vetem paraqitjen e një kontratë bashkëpunimi ndërmjet operatorëve ekonomik, të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre në qarqe të ndryshme.

Në varësi të zerave të shërbimit që do të marrin përsipër të mbulojnë apo bashkimin e fuqisë punetore dhe stafit , përcaktohet përqindja e pjesëmarrjes dhe elementët koktrete që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje

Referuar sa më sipër legjislacioni i prokurimit publik e njeh të drejtën e shoqërive për t'u bashkuar për të përmbushur një kontratë prokurimi, në kushtet kur kjo kontratë nuk mund të realizohet nga një operator ekonomik.

Pra duke parë natyrën, specifikat dhe përmasën e këtij shërbimi, mënyrën e operimit të Bashkise Shkoder që këtë shërbim e menaxhon nga një strukturë e veçantë e specializuar dhe e strukturuar në nivele të ndryshme do të përbënte një kosto të shtuar

për institucionin tonë copezimi i elementeve te vecante te zerave te preventivit, çka do ta bënte te pa mundur realizimin dhe monitorimin e këtij shërbimi në kostot qe do ti shtoheshin institucionit tonë ndarja ne lote.

Njësia e prokurimit

1. Ermal Dizdari Jurist, ne cilesine e personit Pergjegjes per Prokurimin
2. Erkam Boriçi inxhinier mjedisi, specialist i fushes
3. Ormira Domnori inxhinier mjedisi, specialist i fushes